

POP 2019

PERBALLJA OFERTAVE POLITIKE



KONTRATA SOCIALE

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:



Rr. "Abdyl Frasheri"
Pallati 1/10, shk. 1, ap.3 Tirane



gadc@gadc.org.al



+355 4 22 555 14



www.popalbania.info



+355 68 20 59 301



+355 4 22 555 14

Rreth Projektit

Përballja e Ofertave Politike – POP 2019, është një nismë e rrjetit të 11 organizatave të shoqërisë civile shqiptare në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme lokale të 30 Qershorit 2019.

POP 2019 synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien gjatë zgjedhjeve dhe periudhës pas tyre.

POP është zbatuar suksesshëm gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2013, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2015 dhe Zgjedhjeve Parlamentare 2017. Kjo nismë është mbështetur dhe mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, me fonde të Ambasadës Suedeze në Tiranë.

POP 2019 do të organizohet në bashkitë Durrës, Fier, Kamëz, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë aty ku organizatat e rrjetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

POP 2019 synon:

Të nxisë dialogun mes zgjedhësve dhe kandidatëve, por edhe ndërmjet kandidatëve vetë, duke shërbyer si një platformë diskutimi, ku kandidatët do të mbahen të përgjegjshëm ndaj premtimeve të tyre dhe do të ftohen të nënshkruajnë Kontratën Sociale mes tyre dhe qytetarëve në çdo bashki.

Përmes mjeteve të avokimit / lobimit rrjeti POP 2019 do të përpiqet të arrijë rezultate, duke siguruar që kontratat sociale të mos jenë thjesht një zotim i shkruar, por një angazhim i vazhdueshëm për kryetarët e ardhshëm të bashkive.

Të informojnë qytetarët duke përdorur mediat sociale në lidhje me premtimet dhe përparësitë e kandidatëve dhe partive politike përkatëse si dhe në lidhje me punën që do të kryejnë të zgjedhurit për t'i përbushur ato. Përveç kësaj, faqja online interaktive, do t'u ofrojë qytetarëve shqiptarë një paraqitje shumë të nevojshme të ofertave të partive politike. Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e të zgjedhurve gjatë fushatës elektorale, por edhe gjatë mandatit.

Aktivitetet që do të organizohen në kuadër të POP 2019, ofrojnë mundësi të paanshme dhe të barabarta për të gjitha palët dhe kandidatët në dhënien dhe paraqitjen e objektivave dhe platformave të tyre politike për qytetarët. Diskutimet midis kandidatëve nga parti të ndryshme nxisin politikanët të komunikojnë në mënyrë qytetare me njëri-tjetrin dhe synojnë të japin një shembull të mirë për publikun e gjerë në lidhje me kuptimin dhe mbështetjen që politikanët i ofrojnë komuniteteve të tyre pavarësisht bindjeve politike.

Në qendër të të gjitha aktiviteteve të POP 2019 do të jenë qytetarët me nevojat dhe shqetësimet e tyre, pasi zhvendosja e debatit publik nga politika drejt platformave politike në periudhën parazgjedhore është e rëndësishme. POP 2019 është një mundësi për partitë politike që të paraqesin programet e tyre të tregojnë se sa do të kujdesen për qytetarët në katër vitet e ardhshme. Premtimet e partive politike dhe programet e tyre do të monitorohen pas Zgjedhjeve Lokale 2019 nga Rrjeti i organizatave të POP 2019 dhe grupet e qytetarëve që do të organizohen nga ky rrjet.

ORGANIZATAT

- | | |
|--|--|
| • Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim", Tiranë | • Intelektualët e Rinj "Shpresë", Shkodër |
| • Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës | • Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë |
| • Qendra Rinore Vlorë | • Qendra Rinore për Progres, Kukës |
| • ACPD/Qendra "Aulona", Vlorë | • Integrimi, Aktivizimi dhe Ndërgjegjësimi i të Rinjve, Pogradec |
| • Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz | • Lëvizja "Mjaft" |
| • Epoka e Re, Fier | |

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE

Banorë të Bashkisë Kukës u përfshinë në 3 Forume, të zhvilluara gjatë muajit mars 2019 me qëllim identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej tre Forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, si dhe studentë, shtëpiake apo persona të grupeve të marginalizuara.

Pjesëmarrja sipas gjinive

Burra 36 %

Gra 64 %

Në çdonjërin prej forumeve të zhvilluara qytetarët diskutuan gjerësisht mbi 21 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:



Shërbimet publike



Zhvillimi ekonomik vendor



Dimensioni social




Demokracia vendore

Për secilën prej 22 çështjeve objekt diskutimi qytetarët dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi çështjet që përbëjnë prioritet për ta e për rrjedhojë duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendor.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u organizuan në dy grupe:

1. **Ndërhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;



52 janë prioritetet e komunitetit të prezantuara gjerësisht në vijim, sipas shkallës së rëndësisë që i ka dhënë vetë komuniteti, për të cilat do të lobohet për të qenë pjesë e axhendës së të zgjedhurve të rinj vendor, sikurse përmbushja e të cilave do të monitorohet në vijim nga vetë komuniteti.

PRIORITETET E KOMUNITETIT

● Grupi i parë / NDËRHYRJE PRIORITARE ●

Janë **13 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë shumë prioritare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

- Nxitja e bizneseve
- Incentiva në mbështetje të fermerëve
- Nxitja e punësimit
- Mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi transparent i buxhetit

SHËRBIMET PUBLIKE

- Ndriçimi
- Pastrimi
- Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet
- Shkollat
- Transporti Publik

DIMENSIONI SOCIAL

- Gratë
- Grupe në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror¹
- Komuniteti Egjiptian
- Të rinjtë

● Grupi i dytë / NDËRHYRJE DISI PRIORITARE ●

Janë **9 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë disi prioritare.

SHËRBIMET PUBLIKE

- Rugët dhe trotualet
- Gjelbërimi
- Pyjet dhe Kullotat
- Kopshtet dhe Çerdhet
- Kanalet kulluese

DEMOKRACIA VENDORE

- Informimi dhe komunikimi
- Transparenca në vendimmarrje
- Pjesëmarrja në vendimmarrje

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

- Planifikimi strategjik



¹ Në këto grupe përgjithësisht përfshihen: të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, familjet përfituese të ndihmës ekonomike, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, persona të pastrehë, fëmijët pa kujdes prindëror, përdorues të alkoolit apo drogave etj.

● ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR ●

NXITJA E BIZNESEVE

Bashkia Kukës nuk ka një strategji të mirëfilltë dhe afatgjatë në lidhje me politikat apo planet për nxitjen e biznesit privat. Banorët shprehen se janë miratuar disa lehtësira fiskale për bizneset e reja por janë të pamjaftueshme. Sipas forumeve me këtë komunitet, mësohet se ka patur disa përpjekje nga ana e pushtetit vendor për afrimin e industrisë fashone në Kukës por, momentalisht egziston vetëm një rrobaqepësi me 30 – 40 punonjës, e cila nuk përmbush nevojat. Ndaj, duhet një plan më afatgjatë dhe i mirëstrukturuar për nxitjen e bizneseve dhe rrjedhimisht hapjen e vendeve të reja të punës. Njësoj edhe për nxitjen e bizneseve të ngritura nga të rinjtë apo gratë, banorët shprehen se duhen plane konkrete, të prezantuara në kohë dhe me mbështetje për çdo iniciativë të tillë. Banorët shprehen se ka patur një tendencë me disa iniciativa që mbështesin biznese në start up. Nëse bashkia cakton një fond të veçantë për të kontribuar me një sasi të caktuar për këto biznese do të ishte një ndihmë e madhe jo vetëm për të rinjtë apo gratë që duan të ngrehin biznes në Kukës por për të gjithë komunitetin.

Prioritet 1: Hartimi i një strategjie të mirëfilltë afatgjatë për nxitjen e biznesit. Pjesëmarrës me kontribut direkt në rastet e programeve start up për komunitetin e Kukësit.

Prioritet 2: Nxitja e bizneseve për krijimin e vendeve të reja të punës.

Prioritet 3: Nxitje dhe mbështetja e bizneseve të ngritura nga të rinjtë apo/dhe gratë me një linjë specifike buxheti.

MBËSHTETJE TË FERMERËVE

Fermerët pjesëmarrës në forumet e organizuara në Kukës, nuk kanë informacion në lidhje me shërbimet këshilluese nga bashkia në lidhje me bujqësinë në zonat e tyre. Megjithatë, ata shprehen se ka raste që punonjës të Drejtorisë së Bujqësisë takohen me fermerët, por sipas tyre informacioni është shumë i paktë.

Prioritet 4: Rritja e informacionit këshillimor për bujqësinë si dhe dhënia e mundësisë që fermerët të përfitojnë nga këto shërbimeve.

Prioritet 5: Ndërtimi i një pike grumbullimi dhe përpunimi të qumështit dhe të fruta perimeve.

NXITJA E PUNËSIMIT

Banorët e bashkisë Kukës shprehen se papunësia është një prej problemeve më të mëdha që kanë. Shtresa që vuan më shumë nga mungesa e punës janë të rinjtë, kjo ka sjellë edhe emigrimin në masë të kësaj kategorie moshe. Banorët nuk kanë informacion nëse bashkia ka bërë përpjekje për nxitjen e punësimit apo nëse ka një

strukturë që merret në mënyrë direkte me këtë çështje. Gjithashtu, njësoj, nuk janë në dijeni të programeve të veçanta për nxitjen e punësimit të të rinjve, grave apo/dhe grupeve në nevojë. Ata shprehen se nxitja e punësimit është shumë i rëndësishëm dhe se bashkia duhet të marrë masa konkrete. Sipas një marrëveshje qeveritare mes Shqipërisë dhe Kosovës, banorët e zonave kufitare respektive përfitojnë trajnime profesionale falas. Në rastin e Kukësit, ky komunitet mund të ndjekë pa pagesë trajnime të tilla profesionale në Prizren. Qendra e trajnimeve profesionale të Prizrenit mund të ndërtojë një program të mirëfilltë trajnimi ndërkohë që bashkia Kukës mund të sigurojë transportin.

Prioritet 6: Informimi nga ana e bashkisë në lidhje me programet egzistuese të punësimit.

Prioritet 7: Krijimi i programeve nga ana e bashkisë për nxitjen e punësimit sidomos për grupet më pak të avantazuara në tregun e punës:

- Të rinjtë e sapo diplomuar.

- Gratë.

- Gratë viktimë të dhunës në familje.

Prioritet 8: Shfrytëzimi i kapaciteteve të trajnimit profesional për të rinjtë dhe jo vetëm, në Kukës dhe Prizren.

Prioritet 9: Ofrimi nga ana e bashkisë së transportit pa pagesë për pjesëmarrësit në trajnimet profesionale në Prizren.

MBLEDHJA E TË ARDHURAVE DHE PLANIFIKIMI I BUXHETIT

Një pjesë e konsiderueshme e banorëve në bashkinë Kukës, sidomos në fshatrat e kësaj bashkie, shprehen se shpesh nuk i paguajnë taksat, e vetmja pagesë që bëjnë është ajo e ujit të pijshëm, që edhe në këtë rast nuk është pagesë e rregullt dhe sistematike.² Ndërkohë që banorët e njësive administrative Kukës shprehen se paguajnë gjelbërimin dhe pastrimin si familjarë por shprehen se është i nevojshëm informimi i publikut dhe mbledhja e detyrimeve nga të gjitha kategoritë. Ndërkohë që njoftimet për detyrimin e tarifave/taksave vendore, merren si të mirëqëna dhe banorët shprehen se ata nuk informohen. Gjithashtu në Kukës nuk janë bërë fushata sensibilizuese për mbledhjen e taksave apo tarifave vendore.

Prioritet 10: Mbledhja e detyrimeve për të gjithë banorët njësoj.

Prioritet 11: Njoftimi në mënyrë të rregullt i komunitetit për detyrimet e tarifave apo/dhe taksave vendore.

Prioritet 12: Organizimi i fushatave sensibilizuese për mbledhjen e taksave.

SHËRBIMET PUBLIKE

NDRIÇIMI

Në bashkinë Kukës, rrugët kryesore janë të ndriçuara, por rrugët e brendshme nëpër lagje janë komplet në errësi. Lagja nr. 3 është pjesërisht e ndriçuar, ndërsa problematikë për këtë shërbim mbeten lagjet nr. 1, nr. 4 dhe nr. 5. Probleme me ndriçimin kanë edhe njësitë administrative përveç asaj Shtiqen e cila rrugët kryesore i ka të ndriçuara.

Prioritet 13: Adresimi dhe marrja e masave për ndriçimin e zonave të banuara në bashkinë Kukës.

PASTRIMI

Qyteti i Kukësit pastrohet në mënyrë të rregullt, por ka problematika me koshat e mbetjeve të cilët janë të amortizuar dhe të pa ndryshuar prej shumë kohësh. Ndërkohë që në njësitë e tjera administrative shërbimi i pastrimit është pothuajse jo egzistent. *"Nuk ka fare pastrim, bashkia vjen vetëm një herë në disa muaj dhe mbledh mbetjet në formë aksioni."*³

Ndërkohë që e njëjta situatë pak a shumë paraqitet edhe për njësitë e tjera administrative. Vetëm në Bicaj aksione të tilla bëhen një herë në javë, ndërsa në njësitë e tjera administrative organizohen një herë në disa javë. Kjo, sipas banorëve vjen si arsye e mungesës së infrastrukturës.

Prioritet 14: Ndërrimi i koshave të mbetjeve në qytet.

Prioritet 15: Adresimi dhe gjetja e një mënyrë që shërbimi i pastrimit nëpër njësitë e tjera administrative të bëhet frekvente dhe në mënyrë të rregullt.

FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM DHE KANALIZIMET

Furnizimi me ujë të pijshëm ka probleme të theksuara dhe mbetet sfidë, pasi edhe në stinën e dimrit uji është me orar.⁴ Megjithëse ujësjellësi i ri dhe depoja e re e ujit e kanë përmirësuar disi situatën, banorët shprehen se përsëri shërbimi është larg pritshmërive.

Ndërkohë që në lidhje me kanalizimet, banorët shprehen se një pjesë e mirë e lagjeve i kanë kanalizimet e pranueshme, por një pjesë tjetër nuk kanë fare kanalizime. Ndaj, për këtë arsye ata e cilësojnë këtë shërbim si shumë prioritar duke qenë se kanë frikë të rrezikohen nga ndotja e ujërave dhe rrjedhimisht shëndeti i banorëve. Edhe një njësinë administrative Shtiqen banorët shprehen se nuk kanë fare kanalizime dhe përveç kësaj, shkollat nuk kanë as furnizim me ujë të pijshëm.

Prioritet 16: Krijimi i mundësisë dhe ndërhyrja që uji i pijshëm të jetë pa ndërprerje.

Prioritet 17: Adresimi i problematikave me kanalizimet e ujërave të zeza dhe marrja e masave imediate për rregullimin e tyre.

SHKOLLAT

Shkollat cilësohen si një problem emergjent nga banorët e bashkisë Kukës. Ata shprehen se gjendja e tyre është e mjerueshme që nga godina kryesore dhe deri tek palestra apo laboratorët.

Gjithashtu, edhe gjendja e higjienës së ambjenteve është shumë problematike duke përfshirë këtu edhe tualetet dhe mungesën e ujit në godina.⁵ Ndërkohë që në Shtiqen shkolla është rikonstruktuar këtë vit, por mbeten problematikë këtu edhe tualetet dhe mungesa e furnizimit me ujë. Ndërkohë që në atë zonë shkolla Kodër Lumë po mbyllet.

Prioritet 18: Kërkesa për një program të mirëfilltë higjienë i të gjitha shkollave në bashkinë Kukës si dhe marrja e masave për furnizimin e tyre me ujë të pijshëm.

Prioritet 19: Pajisja e shkollave me terrene sportive si dhe me laboratorë, duke qenë se të gjitha shkollat në këtë bashki i kanë këto mungesa.

TRANSPORTI PUBLIK

Transporti Publik nuk egziston në bashkinë Kukës. Banorët më së shumti lëvizin me makina private apo me transport me fugona provat. Mbetet shumë problematikë lëvizja e banorëve të cilët jetojnë në njësi të ndryshme administrative dhe punojnë në qytetin e Kukësit.⁶

Ndërkohë që në Shtiqen por jo vetëm, ka raste që fëmijët ecin 5 km për të frekuentuar shkollën çdo ditë, ndërsa fëmijët të cilët ndjekin shkollën në qytet udhëtojnë çdo ditë me transport privat.

Prioritet 20: Formalizimi i transportit publik në të gjithë bashkinë Kukës.

3 Njësia administrative Shtiqen

4 Njësia administrative Kukës

5 Njësia administrative Kukës

6 Bicaj, Shishtavec, Shumri, Bushtrivë

● DIMENSIONI SOCIAL

GRATË

Banorët nuk kanë dijeni nëse bashkia ka programe të veçanta për adresimin e dhunës në familje. Gjithashtu ata shprehen se ka fushata ndërgjegjësimi nga OJF ku bashkia bëhet pjesë, por jo fushata të ndërmarrë prej saj.

Ndërkohë që banorët shprehen të kënaqur me numrin e grave punonjëse në administratë por shprehin rezervat e tyre në lidhje me përfaqësimin e gruas në Këshillin Bashkiak, ku sipas tyre numri është shumë i vogël krahasuar me numri total të këshilltarëve.

Prioritet 21: Informimi i komunitetit në lidhje me programe të veçanta të bashkisë që adresojnë dhunën në familje apo atë me bazë gjinore.

Prioritet 22: Organizimi nga ana e bashkisë i fushatave ndërgjegjëse kundër dhunës ndaj gruas.

Prioritet 23: Rritja e numrit të grave përfaqësuese të Këshillit Bashkiak.

GRUPE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR

Banorët shprehen se nuk ka shërbime rehabilituese të ngritura nga Bashkia për viktimat e dhunës në familje, të tilla si: shërbime psikologjike, këshillim ligjor, strehim emergjence. Sipas banorëve egziston një qendër e Shërbimit Social e cila është aktive dhe duhet mbështetur, por ajo nuk ofron strehim ditor apo të gjatë. Më së shumti kjo qendër funksionon për fëmijët me aftësi ndryshe dhe persona të moshës së tretë, kryesisht burra.

Prioritet 24: Ngritja e qendrave për gratë e dhunuara

Prioritet 25: Ngritja e mekanizmit të referimit dhe funksionimi i tij në mënyrë të rregullt.

Prioritet 26: Ngritja e një Strehëze sociale për afat të gjatë strehimi.

Prioritet 27: Ngritja e një qendre të mirëfilltë rinore

KOMUNITETI ROM EGJIPTIAN

Në bashkinë Kukës nuk ka komunitet të mirëfilltë Rom, më së shumti ata janë kalimtarë dhe qendrojnë vetëm për disa ditë. Ndërkohë që ata shprehen se në Kukës ka banorë që i përkasin komunitetit Egjiptian por sipas tyre (banorëve) nuk kanë dijeni nëse bashkia ka programe të veçanta për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe përfshirjes sociale të këtij grupi. Përveç rastit të fëmijëve që sipas banorëve, egziston një program për mbrojtjen e tyre, por është shumë pak dhe bashkia duhet të punojë më shumë dhe me masa konkrete për këtë komunitet.

Prioritet 28: Forcimi dhe zhvillimi i programeve për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit Egjiptian si dhe informimi i tyre për shërbimet nga të cilat ata mund të përfitojnë.

TË RINJTË

Banorët shprehen se të rinjtë nuk kanë mbështetje dhe kanë nevojë për programe të veçanta si për formimin e tyre profesional gjithashtu edhe për punësimin në vijim, duke qenë se papunësia, sidomos për këtë grup është shumë e lartë.

Prioritet 29: Krijimi i programeve për mbështetjen dhe edukimin e të rinjve.

Prioritet 30: Mundësia e punësimit për këtë kategori.



Zona urbane dhe zona jo formale (lagjet e reja), Kukës

SHËRBIMET PUBLIKE

RRUGËT DHE TROTUARET

Rrugët dhe trotuaret kryesisht janë të rregulluara, por mbeten problematike rrugët e brendshme, ato periferike si dhe ato në njësitë administrative larg qendrës. Mbeten problematike lagjet 1, 4, dhe 5 në Kukës, si dhe rrugët ndërlidhëse me tokat bujqësore në njësi të tjera administrative. Mbeten problematike lagjet 1, 4, dhe 5 në Kukës, si dhe rrugët ndërlidhëse me tokat bujqësore në njësi të tjera administrative, gjithashtu dhe rastet e zonave rurale dhe rrugët ndërlidhëse me njësitë administrative Surroj, Caje, Fshat, Zapod, Orgjost, Kalis, Arren të cilat janë të pa asfaltuara dhe në gjendje shumë të keqe.

Prioritet 31: Adresimi dhe rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në lagjet 1, 4 dhe 5⁷.

Prioritet 32: Adresimi dhe marrja e masave për rregullimin e rrugëve Surroj, Caje, Fshat, Zapod, Orgjost, Kalis, Arren si dhe të të gjitha njësive të tjera administrative ku ka problematika.

GJELBËRIMI

Megjithëse ka pemë, shkurre dhe hapësira për gjelbërim, banorët shprehen se ato mund të formatohen dhe të mirëmbahen edhe më shumë nga ana e bashkisë.

Prioritet 33: Formatimi dhe mirëmbajtja në mënyrë të rregullt e hapësirave të gjelbra.

Prioritet 34: Rregullimi i hapësirave argëtuese për fëmijë në hapësirat egzistuese në Lagjet: 4, 5, Lagje e re dhe Bozhe.

PYJET DHE KULLOTAT

Banorët shprehen se për drutë e zjarrit një pjesë e mirë e tyre i presin në mal, ndërsa ka shumë banorë të tjerë që i blejnë nga tregtarët (të ligjshëm dhe të paligjshëm). Ata kërkojnë që të formalizohet tregu i drurit të zjarrit. Ndërkohë që sipas tyre bashkia ka marrë masa për parandalimin e zjarrit në pyje dhe kullota por më shumë punë duhet bërë që të mos ketë dëmtime.

Prioritet 35: Formalizimi i tregtisë së druve të zjarrit

Prioritet 36: Rritja e kujdesit dhe e punës për parandalimin e zjarreve dhe dëmtimeve në pyje dhe kullota.

KOPSHTET DHE ÇERDHET

"Kopshtet dhe çerdhet janë të mirëmbajtura dhe funksionojnë pranueshëm. Ka patur ndërhyrje cilësore, por hapësirat para godinave duhet të bëhen më të përshtatshme për fëmijët"⁸ "Në njësi ka dy kopshte. I riu po ndërtohet dhe ju shërben shumë fëmijëve. Është shumë e nevojshme që të përfundohet sa më shpejt."⁹

Prioritet 37: Rregullimi i hapësirave për fëmijët përpara kopshteve dhe çerdheve

Prioritet 38: Përfundimi sa më shpejt i kopshtit nr. 2 në Shtiqen.

Prioritet 39: Mbështetje me bazë materiale dhe educative në të gjitha kopshtet dhe çerdhet egzistuese në bashkinë Kukës

KANALET KULLUESE

Njësia administrative Shtiqen ka kanalin vaditës më të madh në Kukës, i cili është rikonstruktuar plotësisht. Ndërkohë që kanalet e kullimit janë me probleme njësoj si edhe kanalet dytësore. Por, përgjithësisht ka ujë për vaditje.

Ka nevojë për ndërhyrje në kanalin vaditës Shishtavec – Novosej, në atë të Bushatit, i cili në fakt ka filluar po punohet dhe banorët kërkojnë finalizimin sa më të shpejtë

Prioritet 40: Rregullimi i problematikave të kanaleve kulluese dhe dytësore në Shtiqen.

Prioritet 41: Ndërhyrje emergjente në kanalin vaditës Shishtavec – Novosej

Prioritet 42: Përfundimi sa më i shpejtë i kanalit vaditës të Bushatit.

Prioritet 43: Rikonstruksioni i të gjitha kanaleve vaditëse në njësitë administrative të Kukësit.

POP
2019

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE

● DEMOKRACIA VENDORE ●

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Banorët shprehen se janë disi të informuar në komunikim me pushtetin vendor, nuk kanë problematika në marrjen e dokumentave dhe gjenda civile funksionon mirë. Bashkia ka webfaqe dhe rrjete sociale ku publikon në mënyrë të rregullt dhe është aktive. Sipas banorëve ndoshta duhet të jete më e qartë në detajet që përçon sidomos në aktivitetet që kanë të bëjnë me vendimmarrjen. Ndërkohë që në njësitë administrative në kufi me qytetin nuk kanë zyra informacioni.

Prioritet 44: Dhënia e informacionit më të qartë dhe më të kuptueshëm nga komuniteti.

Prioritet 45: Gjetje të rrugëve alternative për komunikim të shtuar me banorët e zonave rurale larg qendrës.

TRANSPARENCA NË VENDIMMARRJE

Banorët shprehen se shpesh bëhen shpallje dhe medial lokale transmeton njoftimet e rëndësishme sipas rasteve.¹⁰ Ndërsa në njësi administrative është pak më e vështirë situata e transparencës në vendimmarrje që ka të bëjë direkt me ta duke qenë shërbimet apo informacionet i marrin nëpërmjet personave të drejtorive të ndryshme nga mungesa e këndeve të njoftimit.

Prioritet 46: Ngritja e këndeve të informimit pranë njësive administrative

PJESËMARRJA NË VENDIMMARRJE

Sipas banorëve nuk ka procedura apo mekanizma të tjerë për të marrë mendimin e komunitetit. Edhe kur bëhen takime publike “nuk kemi marrë pjesë”...Kryepërqendër janë aktivë dhe të rëndësishëm për komunitetin.

Ata shpesh ndërmjetësojnë për zgjidhjen e problemeve.¹¹ Nga ana tjetër, banorë të ndryshëm të njësive administrative Kukës marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak sidomos në rastet e monitorimit të procedurave të vendim marrjes.

Prioritet 47: Përmirësim i procedurave apo mekanizmave për marrjen e mendimit të komunitetit.

Prioritet 48: Takime periodike si me banorë ashtu edhe me strukturat vendore të qeverisjes (Kryetar të fshatrave, drejtues të institucioneve të tjera në nivel njësie administrative.)

Prioritet 49: Informimi i komunitetit për secilën prej çështjeve të cilat i prekin drejtpërdrejt ata.

Prioritet 50: Buxhetim me pjesëmarrje në mënyrë që qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.



10 Njësia administrative Kukës; 11 Njësia administrative Shtiqen

KONTRATA SOCIALE

● ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Të gjitha njësitë e përfshira në forumet e organizuara në bashkinë Kukës listojnë si prioritet planin strategjik për zhvillim territorial dhe ekonomik të kësaj bashkie, duke qenë se njëzëri edhe pse kishin dijeni për egzistencën e tij, ishin të pa informuar në lidhje me përmbajtjen. Gjithashtu, banorët e kësaj bashkie nuk kishin informacion nëse bashkia kishte programe apo plane konkrete me ndikim në komunitet. Edhe në lidhje me përfshirjen në këto plane të çështjeve të të rinjve, grave apo dhe grupeve/njerëzve në nevojë, banorët pjesëmarrës në forume u shprehën se nuk kishin informacion.

Prioritet 51: Informacion për qytetarët në lidhje me përmbajtjen e planeve strategjike të bashkisë Kukës, sidomos në lidhje me gratë, të rinjtë, fermerët dhe grupet në nevojë.

Prioritet 52: Zhvillim i qëndrueshëm si dhe përmirësim i situatës social ekonomike.





**POP
2019**

**PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE**

KONTRATA SOCIALE



Mbështetur nga:



Zbatuar nga:

